

Informacione të rëndësishme për shtrimin e kërkesës për azil për azilkërkuese dhe azilkërkues

ALBANISCH

Cilat dokumente janë të nevojshme gjatë shtrimit të kërkesës?

Shtrimi i kërkesës është termi juaj i parë tek Enti Federal për Migracion dhe Refugjatë. Ne ju pyesim juve për të dhënat tuaja personale si dhe për vendbanimin, formimin shkollor dhe profesional, njohuritë gjuhësore dhe rrugën e udhëtimit. Një përkthyes ose një përkthyes i përkthen të gjitha ato që thoni ju.

Për përpunimin e shpejtë të kërkesës suaj për azil, ju lutemi, sillni me vete dokumentet dhe provat e mëposhtme, **derisa ekzistojnë**, në formë letre:

Dokumente personale - ju lutemi vetëm dokumente origjinale

- Pasaportë udhëtimi
- Letërnjoftim
- Librezë shkolle
- Certifikatë lindjeje
- Patentë
- Ekstrakt nga regjistri i familjes
- Librin e familjes
- Certifikatë martese
- Librezë ushtarake
- Letërnjoftim shërbimi
- Letërnjoftim anëtarësie
- Vërtetime pune
- Dëftesa (nga dëftesat do të përpilohet vetëm një kopje, ju mund ta merrni origjinalin përsëri me vete pas shtrimit tuaj të kërkesës për azil)

Dëshmi për arsyet e arratisjes

- Fotografi
- Vendime ose aktvendime nga procedura gjyqësore
- Urdhra arresti
- Kallëzime në lidhje me hetime policore ose dokumente të tjera nga policia
- Letra kërcënimi
- Artikuj gazetash (me përmendje specifike emri)
- Certifikata pagëzimi
- Postime nga mediat sociale (Facebook, Instagram, Twitter e kështu më tej) me referime për arsyet e arratisjes suaj
- Dokumente të tjera, si p.sh. letra nga dëshmitarë

Raporte

- Raport mjekësor
- Letër nga mjeku
- Ekspertizë psikologjike
- Raport mbi vepra dhune/tortura
- Raport tjetër

Vini re: Sillni me vete dokumente të rëndësishme për rastin tuaj. Këto dokumente ju duhet t'i sillni me vete **të printuara**. Nëse ju dokumentet i keni digjitale, pyesni në strehimin tuaj, ku mund t'i printoni këto dokumente.

Raportet mund të vijnë nga vendi i prejardhjes suaj, nga një vend i tretë ose nga Gjermania. Nëse është e nevojshme shkoni tek një mjek.

Ju lutemi na jepni ne po ashtu adresën tuaj, nëse ju **nuk** jeni strehuar në institucionin e pranimit fillestar dhe iu caktuat një strehimi tjetër.

Nëse ju keni shtruar një kërkesë për azil, ju merrni një lejim qëndrimi për kohëzgjatjen e procedurës suaj të azilit. Mbaheni këtë gjithmonë me vete.